



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-56057 të datës 11.11.2020 së OJQ-së "The Ideas Partnership" T.I.P me seli në Prishtinë, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 450 € (katërqind e pesëdhjetë euro) OJQ-së "The Ideas Partnership" T.I.P me seli në Prishtinë sipas kërkesës të tyre Nr.1-400-56057 të datës 11.11.2020, për ta mbështetur financiarisht për realizimin e aktiviteteve në fushën e arsimit, shëndetësis dhe fushën sociale për komunitetin në Janjevë.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të OJQ-së "The Ideas Partnership" T.I.P" në nr. 1110305926000115 në ProCredit Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara, OJQ-ja "The Ideas Partnership" T.I.P me seli në Prishtinë duhet të sjellë raport narrativ dhe financiar duke i bashkëngjitur faturat të cilat dorëzohen në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me 30.05.2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet OJQ-ja "The Ideas Partnership" T.I.P me seli në Prishtinë.

1Nr. 400-56057
Lipjan, më 09.12.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

